



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr.1674/2Prot.

Tiranë, më 18.12.2018

**V E N D I M**

**Nr. 249, Datë 18/12/2018**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 185, datë 27.11.2018, e Z. D. D., ku pretendohet për diskriminim në formën e shqetësimit, për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “për shkak të aplikimit të ankuesit, për t’u zgjedhur si anëtar në Këshillin Koordinues të Diasporës”, nga ana e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK)

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri,

**K O N S T A T O I:**

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, rezulton se në datën 06.10.2018, mbështetur në të drejtën për informim, Z. D. D. i është drejtuar me e-mail, Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK), me një kërkesë ku kërkohet informacion mbi 10 (dhjetë) çështje të parashtruara nga ana e tij. Në kushtet, kur ky institucion nuk ka dërguar përgjigje, ankuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëpërmjet shkresës nr. 1572/1, datë 30.10.2018, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kërkuar nga ana e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK), të marrë në vlerësim